

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Niveli i pagave në Kosovë, 2024

30.05.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar “Nivelin e Pagave në Kosovë” për vitin 2024.

Ky publikim përmban të dhëna për pagën mesatare bruto dhe neto sipas sektorëve dhe aktiviteteve ekonomike në Sektorin Publik (Administrata), Ndërmarrjet Publike dhe Sektorin Privat në Kosovë.

Në vitin 2024, pagat mesatare bruto në Kosove ishin 639 Euro, derisa në vitin 2023 ishin 570 Euro. Pra, kishte një rritje prej 69 Eurosh nga viti paraprak. Kurse, paga neto, në vitin 2024 ishte 552 Euro, krahasuar me vitin 2023 që ishte 506 Euro. Pra, një rritje prej 46 Eurosh.

Paga mesatare bruto në sektorin privat, në vitin 2024 ishte 598 Euro, derisa në vitin 2023 ishte 515 Euro. Pra, kishte një rritje prej 83 Eurosh. Ndërsa, paga mesatare neto ishte 513 Euro, krahasuar me vitin 2023 e cila ishte 459 euro. Pra, një rritje prej 54 Eurosh.

Paga mesatare bruto në sektorin publik në vitin 2020 ishte 624 Euro, derisa, në vitin 2024 ishte 755 Euro, duke u rritur për 131 Euro, ose rreth 21.0%. Ndërsa, paga mesatare neto nga 552 Euro, sa ishte në vitin 2020, u rrit në 668 Euro në vitin 2024. Një rritje prej 116 Eurosh, ose 21.0%.

Paga mesatare bruto në sektorin e ndërmarrjeve publike në vitin 2020 ishte 769 Euro, derisa në vitin 2024 ishte 783 Euro. Një rritje prej 14 Eurosh ose 1.8%. Ndërsa, paga mesatare neto nga 680 Euro, sa ishte në vitin 2020, u rrit në 685 Euro në vitin 2024. Një rritje prej 5 Eurosh, ose 0.7%.

Niveli i pagave më të larta në Kosovë ishte sektori i ndërmarrjeve publike, derisa me paga më të ulëta ishte sektori privat.

Paga mesatare bruto në vitin 2024, sipas aktiviteteve ekonomike, më a larta ishte te: Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (1105 Euro); dhe Informim dhe komunikimi (1090 Euro). Derisa, paga më e ulët ishte te akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim (389 Euro).

Paga mesatare neto në vitin 2024, sipas aktiviteteve ekonomike, ka të njëjtën renditje si më poshtë: Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (970 Euro); Informim dhe komunikim (935 Euro); Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim (331 Euro).